

VENDIM
Nr.101, datë 9.2.2011
PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR LEJET E TRANSPORTIT DHE KRYERJEN E
OPERACIONEVE TË TRANSPORTIT NGA TRANSPORTUESIT E HUAJ, QË NUK KANË
SELINË NË SHQIPËRI (JOREZIDENTË), PËR MALLRA DHE UDHËTARË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 52/1 e 53 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe pikës 1 të nenit 59 të “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”, të ratifikuar me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për lejet e transportit dhe kryerjen e operacioneve të transportit nga transportuesit e huaj, që nuk kanë selinë në Shqipëri (jorezidentë), për mallra dhe udhëtarë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr.532, datë 21.8.1998 i Këshillit të Ministrave “Për lejet e transportit të mallrave për transportuesit, që nuk kanë selinë në Shqipëri”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLAT

PËR LEJET E TRANSPORTIT DHE KRYERJEN E OPERACIONEVE TË TRANSPORTIT
NGA TRANSPORTUESIT E HUAJ, QË NUK KANË SELINË (JOREZIDENTË) NË
SHQIPËRI, PËR MALLRA DHE UDHËTARË

KREU I
KAPITULLI I

TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR RRUGOR I MALLRAVE DHE I UDHËTARËVE

1. Qëllimi

1.1 Rregullorja do të zbatohet për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, të kryer nga transportues të huaj që nuk kanë selinë (jorezidentë) në Republikën e Shqipërisë, për të tretë ose me qira dhe për llogari të vet, të cilët udhëtojnë për në, përmes dhe nga territori i Shqipërisë për jashtë saj.

1.2 Rregullorja do të zbatohet për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, të kryer nga transportues të huaj që nuk kanë selinë (jorezidentë) në Republikën e Shqipërisë, për të tretë ose me qira dhe për llogari të vet, të cilët udhëtojnë për në, përmes dhe nga territori i Shqipërisë për jashtë saj.

1.3 Shteti i vendosjes së transportuesit jorezidentë është edhe shteti i regjistrimit të mjetit motorik, ose në rastin e një kombinimi mjeteesh, të paktën mjete motorik është i regjistruar në atë shtet.

1.4 Rregullorja do të zbatohet edhe për transportin ndërkombëtar rrugor me mjete të pangarkuara.

1.5 Rregullorja do të zbatohet për transportin kombëtar rrugor të mallrave të kryera nga të huaj që nuk kanë selinë në Republikën e Shqipërisë, për të tretë ose me qira brenda territorit të Shqipërisë (kabotazhi), siç parashikohet në kapitullin II të kreut II.

1 Rregullorja e Këshillit (ECC) nr.31993 (OJ L 279, 12.11.1993, f.1-16) Rregullorja (EC) nr.1072/2009 e 21 tetorit 2009 (OJ L 300/2009, f.72, datë 14.11.2009) dhe Rregullorja (EC) nr.1073/2009 e 21 tetorit 2009 (OJ L 300/2009, f.88, date 14.11.2009).

KREU II
KAPITULLI I

KUSHTET E LËSHIMIT TË LEJEVE BILATERALE E MULTILATERALE

1. Kushtet e lëshimit të lejeve bilaterale dhe multilaterale

1.1 Kushtet për lëshimin e lejeve në transportin ndërkombëtar të mallrave, transportuesve jorezidentë, përcaktohen mbi baza reciprociteti në marrëveshjet bilaterale, ose sipas marrëveshjeve multilaterale, të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë.

1.2 Nëse me një shtet, ku marrëveshja bilaterale parashikon që operacionet e transportit, bilaterale ose transite sipas pikës 2.1 shkronja “a” nën-pika “i” të këtij kapitulli të kryhen pa leje, transportuesit e atij shteti mund të udhëtojnë pa kufizim në territorin e Shqipërisë.

2. Llojet e lejeve

2.1 Në përputhje me pikën 1.1 të këtij kapitulli, transportuesit jorezidentë mund të udhëtojnë për në, nga ose përmes territorit të Shqipërisë vetëm nëse këta transportues janë të pajisur:

a) me leje për kryerjen e operacioneve të transportit;

i) bilaterale dhe, ose transite; ose

ii) për në/nga vende të treta (transportit trekëndore), dhe në përputhje me marrëveshjet bilaterale të përfunduara me çdo shtet në veçanti, këto leje mund të jenë dy llojesh, respektivisht, për mjete të zakonshme dhe për mjete të standardit EURO;

b) me licencën multilaterale (ECMT) për operacionet e transportit, për të tretë ose me qira, ndërmjet vendeve anëtare dhe transit përmes territorit të një ose më shumë vendeve anëtare të ECMT-së me mjete të regjistruara në një vend anëtar të ECMT-së, e cila lëshohet nga Forumi Ndërkombëtar i Transportit (ITF);

c) me lejen (autorizimin) multilaterale (BSEC) për operacionet e transportit, për të tretë ose me qira, transit, përmes një ose më shumë shteteve anëtare pjesëmarrëse, të lëshuar nga Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Vendeve të Detit të Zi (BSEC).

2.2 Lejet e transportit të mallrave për vende të treta sipas pikës 2.1 shkronja “a” nën-pika “ii” dhe sipas shkronjave “b” dhe “c” të këtij kapitulli, përdoren vetëm nga transportues të licencuar për transportin ndërkombëtar, për të tretë ose me qira, në shtetin e vendosjes së tyre.

2.2.1 Lejet për kryerjen e operacioneve të transportit, bilaterale dhe, ose transite sipas pikës 2.1 shkronja “a” nën-pika “i” të këtij kapitulli, përdoren nga transportuesit jorezidentë për të tretë ose me qira dhe atyre për llogari të vet.

2.3 Lejet sipas pikës 2.1 për mjetet/kombinimin e mjeteve të standardit EURO, duhet të shoqërohen me certifikatat përkatëse të konformitetit, si licencat e ECMT-së. Në këtë rast, në ndryshim nga operacionet e transportit me licenca ECMT, mjeti nuk shoqërohet me karnetën e rrugës (librin e udhëtimeve).

2.4 Kuota e lejeve të transportit të mallrave sipas shkronjës “a” të pikës 2.1 të këtij kapitulli, vendoset në bazë të reciprocitetit me shtetet përkatëse, ndërsa kuota e lejeve sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2.1 të këtij kapitulli, vendoset respektivisht në bazë të vendimit të miratuar nga Ministrat e Transportit të Europës dhe të Komitetit Drejtues të BSEC-së.

2.5 Lejet sipas pikës 2.1 shkronja “a” të këtij kapitulli kryesisht, janë të vlefshme vetëm për një udhëtim vajtje-ardhje, por në varësi të marrëveshjeve bilaterale, ato mund të jenë të vlefshme edhe për një numër të caktuar udhëtimesh ose për një periudhë të caktuar kohe.

2.6 Lejet sipas pikës 2.1 shkronja “a”, mbajnë si shenjë dalluese stemën e Republikës së Shqipërisë dhe simbolin “AL”, siç parashikohet në ligjin nr.8613, datë 25.5.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për trafikun rrugor” të 8 nëntorit 1968.

2.6.1 Licencat sipas pikës 2.1 shkronja “b” të këtij kapitulli (ECMT), janë të vlefshme vetëm për mjetet e standardit EURO. Niveli i standardit EURO për mjetet/kombinimin e mjeteve, që përdoren në operacionet e transportit ndërkombëtar për të tretë ose me qira ndërmjet vendeve anëtare, vendosen nga Forumi i Transportit Ndërkombëtar (ITF).

2.7 Lejet janë të vlefshme për një vit kalendarik nga 1 janari deri më 31 dhjetor për të cilin janë lëshuar. Në ndryshim nga licencat e ECMT, sipas pikës 2.1 shkronja “b” të këtij kapitulli (ECMT), lejet e lëshuara sipas pikës 2.1 shkronjat “a” dhe “c” të këtij kapitulli për vitin kalendarik të vitit paraardhës, në përputhje edhe me marrëveshjet bilaterale e multilaterale, mund të përdoren deri më 31 janar të vitit pasardhës.

2.8 Licencat sipas pikës 2.1 shkronja “b” të këtij kapitulli (ECMT) janë dy llojesh, afatgjata, të

vlefshme për një vit kalendarik nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit, për të cilin janë lëshuar, dhe afatshkurtra, të vlefshme për 30 ditë.

2.9 Lejet dhe licencat sipas pikës 2.1 shkronjat “b” dhe “c” të këtij kapitulli përdoren për operacionet e transportit, siç përshkruhen në udhëzuesin e përdorimit, respektivisht, të Forumit të Transportit Ndërkombëtar për licencat ECMT dhe Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Vendeve të Detit të Zi për lejet e BSEC.

2.10 Lejet sipas pikës 2.1 shkronja “a” të këtij kapitulli, vlejnë vetëm për mjetin motorik dhe nëse është rasti edhe për një kombinim çift të mjeteve. Mjeti motorik është i regjistruar në vendin e vendosjes së transportuesit jorezidentë, ndërsa rimorkio ose gjysmërimorkio është e regjistruar në vendin/vendet e regjistruar/a të parashikuara në marrëveshjet bilaterale.

2.10.1 Lejet dhe licencat sipas pikës 2.1 shkronjat “b” dhe “c” të këtij kapitulli, vlejnë për mjetin motorik. Ato vlejnë për mjetin motorik edhe në rastin e një kombinimi çift të mjeteve. Mjeti motorik duhet të jetë i regjistruar në vendin e vendosjes së transportuesit jorezidentë, ndërsa rimorkio ose gjysmërimorkio mund të jetë e regjistruar në një prej vendeve anëtare të ECMT-së ose BSEC-së.

2.11 Çdo leje do të përdoret vetëm nga një mjet në të njëjtën kohë. Lejet sipas pikës 2.1 të këtij kapitulli, nuk autorizojnë kryerjen e kabotazhit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2.12 Lejet sipas pikës 2.1 të këtij kapitulli do të kërkohen nga nëpunësit e organeve të kontrollit në pikat e kalimit të kufirit, si dhe do t’u paraqiten nëpunësve të organeve të kontrollit në rrugë, të përmendura në kapitullin II të kreut IV sa herë kërkohen prej tyre.

2.13 Nëpunësit e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit, të përmendura në kapitullin II të kreut IV pas përfundimit të operacionit të udhëtimit vendosin mbi lejen, sipas pikës 2.1 shkronja “a” të këtij kapitulli, datën, firmën dhe vulën e pikës së kalimit në hyrje dhe në dalje të kufirit, me qëllim që ajo të mos përdoret më, si në rastin kur është e vlefshme për një udhëtim vajtje-ardhje, ose për çdo udhëtim vajtje-ardhje të cilit i përket, kur ajo është e vlefshme për një numër të caktuar udhëtimesh, ose kur leja shërben për një periudhë të caktuar kohe.

2.14 Nëpunësit e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit dhe ato të kontrollit në rrugë të përmendura në kapitullin II të kreut IV, së bashku me licencën sipas pikës 2.1 shkronja “b” të këtij kapitulli, duhet të kontrollojnë detyrimisht karnetën e rrugës (librin e udhëtimeve) dhe certifikatat e përputhshmërisë (konformitetit) që provojnë se mjeti/kombinimi i mjeteve është në përputhje me

standardet përkatëse të kërkuara. Për çdo kontroll ata duhet të vendosin shënimet përkatëse në librin e udhëtimeve.

2.15 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në fund të çdo viti paraardhës, ose rast pas rasti gjatë vitit, njofton organet e kontrollit të përmendura në kapitullin II të kreut IV lidhur me llojet dhe sasinë e lejeve të transportit ndërkombëtar të mallrave që shkëmbehen me çdo shtet, si dhe shtetet, mjetet e të cilëve janë të përjashtuar nga lejet e transportit ndërkombëtar të mallrave.

2.16 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit i dërgon organeve të kontrollit të përmendura në kapitullin II të kreut IV udhëzuesin e përdorimit, respektivisht, të Forumit të Transportit Ndërkombëtar për licencat ECMT dhe Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Vendeve të Detit të Zi për lejet e BSEC.

2.17 Leja ose licenca sipas pikës 2.1 shkronjat “a”, “b” dhe “c”, duhet të përmbajë kryesisht të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e transportuesit ose shoqërisë së transportit, si dhe adresën/selinë, si dhe adresën e plotë të transportuesit ose shoqërisë së transportit;

b) firmën dhe vulën e organit që e lëshon;

c) datën e lëshimit;

ç) datën e fillimit dhe të përfundimit të vlefshmërisë së licencës ose lejes.

2.17.1 Nëse një leje ose licencë sipas pikës 2.1 shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij kapitulli, nuk përmban të dhënat e mësipërme që i përkasin asaj, ajo konsiderohet e pavlefshme.

2.18 Lejet sipas pikës 2.1 shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij kapitulli shpërndahen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

3. Transportet transite përmes territorit të Shqipërisë nga transportues të vendosur në një shtet anëtar të BE-së.

3.1 Në ndryshim nga pika 2.1 e këtij kapitulli, operacionet transite të transportit të mallrave

përmes territorit të Republikës së Shqipërisë nga transportues të vendosur në një shtet anëtar të BE-së do të kryhen:

a) pa kufizime (pa leje bilaterale) në rastin kur një transportues i vendosur në një shtet anëtar të BE-së udhëton transit përmes territorit të Shqipërisë me itinerar për në ose nga një shtet anëtar të BE-së;

b) me leje bilaterale, ose sipas regjimit të vendosur në marrëveshjen bilaterale ndërmjet Shqipërisë dhe çdo shteti anëtar të BE-së, në veçanti, në rastin kur një transportues i vendosur në një shtet anëtar të BE-së udhëton transit përmes territorit të Shqipërisë me itinerar për në ose nga një vend i tretë, shtet joanëtar të BE-së.

3.1.1 Transportuesit e vendosur në një shtet anëtar të BE-së dhe, të cilët kryejnë udhëtime transite sipas pikës 3.1 shkronja “a” e këtij kapitulli, duhet të jenë të pajisur me licencën komunitare ose një kopje e certifikuar e saj, si dhe me kontratën e transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave në përputhje me ligjin nr.9503, datë 3.4.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR) dhe Protokollin e Nënshkrimit”.

3.2 Nëpunësit e organeve të kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit dhe ato të kontrollit në rrugë, të përmendura në kapitullin II të kreut IV për sa i përket transportuesve të vendosur në një shtet anëtar të BE-së do të veprojnë në përputhje me pikën 2.10.1 dhe 2.14 vetëm në rastin e parashikuar në pikën 2.1 shkronja “b”.

4. Refuzimi në hyrje dhe heqja e lejes bilaterale dhe multilaterale për transportuesit jorezidentë.

4.1 Refuzimi i hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të mjetit të një transportuesi jorezident, bëhet nga organet e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit, të përmendura në kapitullin II të kreut IV, në rastet kur:

a) nuk është pajisur me njërën prej lejeve sipas pikës 2.1 të këtij kapitulli, të këtij kreu, kur në marrëveshjet bilaterale nuk parashikohet ndryshe;

b) mjete nuk plotëson kushtet teknike për qarkullimin në rrugë;

c) kryen kabotazh të papajisur me lejen e dokumentacionin e nevojshëm shoqëruar;

ç) nuk është i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për transportin ndërkombëtar;

d) nuk plotëson kërkesat në lidhje me transportin e disa kategorive të mallrave, sidomos në transportin e mallrave të rrezikshme, ushqimeve që prishen shpejt, kafshëve të gjalla;

dh) nuk është i pajisur nga autoriteti rrugor shqiptar me një autorizim special për transportet me mjete jashtë norme dhe për transportet në kushte jonormale, që i kalojnë peshat dhe, ose përmasat sipas neneve 10, 61 ose 62 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”;

e) leja ose licenca është e pavlefshme, siç parashikohet në pikën 2.17.1 të këtij kapitulli.

4.1.1 Refuzimi i hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të një mjete të një transportuesi jorezident bëhet për një afat jo më pak se 6 muaj dhe afat maksimal deri në 2 vjet.

4.2. Lejet ose licenca sipas pikës 2.1 shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij kapitulli hiqen menjëherë, kur një transportues jorezident:

a) është i pajisur me një leje ose licencë të falsifikuar;

b) është i pajisur me një leje ose licencë të humbur ose të vjedhur;

c) përdor lejen ose licencën që i është caktuar një transportuesi tjetër;

ç) gjatë operacioneve të transportit në territorin e Republikës së Shqipërisë kryen shkelje serioze në transportin rrugor.

4.2.1 Në rastin e shkronjës “a” të pikës 4.2 leja e falsifikuar tërhiqet menjëherë si një provë për procedura të brendshme, nëse kjo nuk nevojitet si provë për procedura të brendshme i dërgohet brenda 30 ditëve vendit anëtar ku transportuesi jorezident është i vendosur.

4.2.2 Në rastin e shkronjave “b” dhe “c” të pikës 4.2 të këtij kapitulli, leja ose licenca e certifikatat, që e shoqërojnë këtë të fundit, origjinale, tërhiqen menjëherë si një provë për procedura të brendshme, nëse këto nuk nevojiten si prova për procedura të brendshme leja ose licenca e certifikatat, që e shoqërojnë këtë të fundit, origjinale i transmetohen brenda 30 ditëve organit të shtetit që i ka lëshuar.

KAPITULLI II

KABOTAZHI

1. Kushtet për lejimin e kryerjes së operacioneve të kabotazhit

1.1 Transportuesit që nuk e kanë selinë (jorezidentë) në Shqipëri, të cilët kryejnë operacione transporti në përputhje me pikën 1.2 të kapitullit I të këtij kreu dhe transportuesit jorezidentë për llogari të vet janë të ndaluar të kryejnë operacione kabotazhi në territorin e Shqipërisë.

1.2 Nëse nuk parashikohet ndryshe në marrëveshjet bilaterale, operacionet e kabotazhit nuk lejohen të kryhen me mjete të transportuesve jorezidentë, ku kapaciteti transportues i lejuar i mjetit nuk kalon masën prej 3.5 tonë.

1.3 Transportuesit që nuk e kanë selinë (jorezidentë) në Shqipëri lejohen të kryejnë operacione kabotazhi, nëse këta transportues operojnë në përputhje me marrëveshjet bilaterale ose multilaterale sipas pikave 2 dhe 3 të këtij kapitulli.

1.4 Leja e kabotazhit i lëshohet një transportuesi të licencuar në transportin ndërkombëtar të mallrave, për të tretë ose me qira në vendin, i cili është vendi:

a) i vendosjes së transportuesit në përputhje me rregullat e këtij vendi; dhe

b) ku ka përfutur të drejtën e pranimit në profesion të operatorit të transportit rrugor të mallrave, në kryerjen e transportit ndërkombëtar të mallrave me rrugë në përputhje me legjislacionin kombëtar të këtij vendi dhe, ose atij të BE-së.

1.5 Në rastin e një kombinimi të mjeteve, leja e kabotazhit dhe kontrata e marrjes me qira, nëse ka, shoqëron mjetin motorik. Ajo mbulon një kombinim të çiftuar të mjeteve edhe në rastin kur rimorkio ose gjysmërimorkio:

a) nuk është e regjistruar ose e autorizuar për përdorim në rrugë në emrin e mbajtësit të licencës; ose kur b) është e regjistruar ose e autorizuar në përdorim në rrugë në një vend anëtar të ECMT-së.

1.6 Si përjashtim nga pika 1.3 e këtij kapitulli, leja e kabotazhit lëshohet edhe në rastin e një emergjence civile. Në këtë rast, afati i vlefshmërisë së lejes është i njëjtë me atë të zgjatjes së emergjencës civile.

1.7 Leja e kabotazhit sipas pikës 2 të këtij kapitulli, duhet t'u paraqitet nëpunësve të kontrollit sa herë kërkohet prej tyre.

2. Operacionet e kabotazhit me kuotë të caktuar lejesh

2.1 Kuota e lejeve për kryerjen e operacioneve të kabotazhit caktohet nga marrëveshjet bilaterale dhe lëshohet nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

2.2 Lejet për kryerjen e kabotazhit nga transportuesit për të tretë ose me qira janë dy llojesh, me afat vlefshmërie 2-mujore dhe afat të shkurtër 1-mujor. Modeli i lejes dhe kushtet e vendosura në të miratohen nga ministri përgjegjës për transportin.

2.3 Leja e kabotazhit lëshohet në emër të transportuesit, i cili nuk mund ta transferojë atë te palët e treta. Çdo leje kabotazhi do të përdoret vetëm nga një mjet në të njëjtën kohë.

2.4 Operacionet e kabotazhit duhet të regjistrohen në një libër, i cili përbëhet nga fletët e regjistrimit të operacioneve që kryhen.

2.5 Pas përfundimit leja kabotazhit dhe fletët e regjistrimit të operacioneve të kabotazhit dorëzohen, brenda 8 ditëve në organin përgjegjës, i cili lëshoi lejen e kabotazhit dhe bllokun. Modeli I librit të udhëtimit përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin.

3. Operacionet e kabotazhit pa kuotë të caktuar lejesh

3.1 Një transportues jorezident i vendosur në një shtet anëtar të BE-së lejohet të kryejë kabotazh në territorin e Shqipërisë vetëm nëse ai është i pajisur me licencën komunitare ose një kopje të certifikuar, ndërsa transportuesit e vendosur në një vend që nuk është anëtar i BE-së duhet të plotësojnë kushtin e pikës 1.4 të këtij kapitulli. Në këtë rast, operacionet e kabotazhit do të kryhen sipas kushteve të këtij kapitulli.

3.2 Kur mallrat e mbartura gjatë një transportimi ndërkombëtar në ardhje janë shpërndarë (dorëzuar), transportuesi i përmendur në pikën 3.1 të këtij kapitulli do të lejohet të kryejë, me të njëjtin mjet motorik, ose, në rastin e një kombinimi çift, me anë të mjetit motorik të të njëjtit mjet, deri në tre operacione kabotazhi në vijim të transportimit ndërkombëtar nga një shtet tjetër për në Shqipëri.

Shkarkimi i fundit gjatë një operacioni kabotazhi para largimit nga Shqipëria duhet të kryhet brenda 7 ditëve që fillon nga dita e shkarkimit të fundit në Shqipëri gjatë transportit ndërkombëtar në ardhje.

3.3 Brenda kufizimit kohor të përmendur në pikën 3.2 të këtij kapitulli, transportuesit kryejnë disa ose të gjithë operacionet e kabotazhit të lejuara në Shqipëri duke plotësuar kushtin që ata janë të kufizuar të një operacion kabotazhi brenda 3 ditëve duke filluar nga dita e shkarkimit të mallrave Brenda territorit e Shqipërisë.

3.4 Shërbimet e transportit rrugor të brendshëm (kombëtare) të kryera në Shqipëri nga një transportues jorezident konsiderohen në përputhje me pikat 3.2 dhe 3.3 të këtij kapitulli nëse transportuesi paraqet prova të qarta të transportit ndërkombëtar në ardhje të tij dhe çdo operacion kabotazhi pasues të kryer.

Prova e përmendur në këtë pikë përmban detajet që vijojnë për çdo operacion:

- a) emrin, adresën dhe nënshkrimin e dërguesit;
- b) emrin, adresën dhe nënshkrimin e transportuesit;
- c) emrin dhe adresën e marrësit, gjithashtu, nënshkrimin e tij dhe datën e dorëzimit pasi mallrat të jenë dorëzuar;
- ç) vendin dhe datën e marrjes në dorëzim të mallrave dhe vendin e caktuar për dorëzim;
- d) përshkrimin për përdorim të përgjithshëm të natyrës së mallrave dhe mënyrën e paketimit, dhe, në rastin e mallrave të rrezikshme, përshkrimin e tyre të përgjithshëm të njohur mirë, si dhe numrin e pakove dhe shënimet e numrat specialë të tyre;
- dh) peshën bruto të mallrave ose sasinë e tyre të shprehur ndryshe;
- e) targat e mjetit motorik dhe rimorkios ose gjysmërimorkios.

4. Rregullat e zbatueshme për operacionet e kabotazhit

4.1 Kryerja e operacioneve të kabotazhit është subjekt i konventave ose marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë transportin rrugor në Republikën e Shqipërisë në lidhje me:

- a) kushtet që rregullojnë kontratën e transportit në përputhje me ligjin nr.9503, datë 3.4.2006;
- b) peshat dhe përmasat e mjeteve rrugore;
- c) kërkesat për transportin e disa kategorive të mallrave, në mënyrë të veçantë, mallrat e rrezikshme, mallrat që prishen shpejt dhe kafshëve të gjalla;
- ç) orët e drejtuesve të mjeteve;
- d) taksën e vlerës së shtuar (TVSH) në shërbimet e transportit;
- dh) peshat dhe përmasat e përmendura në shkronjën “b” të pikës 4.1 të këtij kapitulli, mundet të kapërcejnë ato që aplikohen në shtetin e vendosjes së transportuesit jorezidentë, por në asnjë rrethanë,

nuk mundet të kapërcejnë kufizimet e vendosura në nenet 61 dhe 62 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të cilat zbatohen edhe nga transportuesit shqiptarë.

4.2 Standardet teknike të konstruksionit dhe pajimit që duhet të plotësojnë mjetet të cilat përdoren në operacionet e kabotazhit janë të njëjtat me kushtet e transportit ndërkombëtar.

5. Refuzimi dhe heqja e lejes së kabotazhit

5.1 Leja e kabotazhit i refuzohet një transportuesi jorezident kur:

- a) në transportin ndërkombëtar në ardhje nga shtet tjetër nuk është i pajisur me lejen për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas pikës 2.1 të kapitullit I të kreut II, me përjashtim të rastit kur në marrëveshjen bilaterale ose multilaterale parashikohet ndryshe;
- b) nuk plotësohen kushtet 3.2 dhe 3.3 të këtij kapitulli për transportin ndërkombëtar në ardhje nga shtet tjetër;
- c) nuk është i pajisur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve) me një autorizim special, për transportet që i kapërcejnë peshat dhe, ose përmasat sipas nenit 61 ose 62 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- ç) gjatë kryerjes së operacioneve të mëparshme ka kryer shkelje serioze, të cilat kanë shkaktuar heqjen e lejes sipas pikës 2.1 të kapitullit I të kreut II.

5.2 Leja e kabotazhit i hiqet një transportuesi jorezident kur:

- a) përdor një leje që i është caktuar një transportuesi tjetër;
- b) nuk është i pajisur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve) me një autorizim special, për transportet që i kapërcejnë peshat dhe, ose përmasat sipas nenit 61 ose 62 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- c) kryen shkelje serioze sipas kuptimit të shkronjës “k” të aneksit 1, ose shkelje të vogla të përsëritura të rregullave të transportit;

- ç) përdor një leje të falsifikuar, të vjedhur ose të humbur, e cila konfiskohet dhe i dërgohet menjëherë organeve përgjegjëse në vendin e vendosjes së transportuesit;
- d) nuk ka plotësuar në kohë dhe siç duhet librin e udhëtimeve;
- dh) kur shkelen kushtet e vendosura në lejen e kabotazhit.
- 5.3 Kur hiqet një leje kabotazhi sipas pikës 2 të këtij kapitulli, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit vepron në përputhje me pikën 3.2 të kapitullit I të kreut IV.

KREU III
TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR RRUGOR ME AUTOBUS I UDHËTARËVE
KAPITULLI I
HYRJA NË TREG

1. Shërbimet e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, subjekt për autorizim

1.1 Transportuesit rrugorë ndërkombëtarë jorezidentë të udhëtarëve për të tretë ose me qira kryejnë në territorin e Shqipërisë:

- a) shërbime të rregullta;
- b) shërbime të rregullta të specializuara, kur sipas marrëveshjes bilaterale është subjekt për autorizim;
- c) shërbime vajtje-ardhje; dhe
- ç) shërbime të rastit të paliberalizuara.

1.2 Shërbimet sipas pikës 1.1 shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij kapitulli janë subjekt i autorizimit. Modeli i autorizimit të lëshuar caktohet sipas rastit ose nga marrëveshjet bilaterale e multilaterale ose me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin.

1.3 Autorizimi për shërbimet sipas pikës 1.1 të këtij kapitulli lëshohet nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ose organi i caktuar për këtë qëllim në përputhje me marrëveshjet bilaterale ose multilaterale.

1.4 Shërbimet e rastit të paliberalizuara, të parashikuara në Marrëveshjen Interbus ose në marrëveshjet bilaterale të përfunduara kërkojnë autorizim.

1.5 Transportet transite përmes territorit të Shqipërisë nga transportuesit jorezidentë, të cilët kryejnë shërbime sipas pikës 1.1 të këtij kapitulli janë subjekt për autorizim.

1.6 Udhëtimet bosh të autobusëve në lidhje me shërbimet e 1.1 të këtij kapitulli janë subjekt për autorizim.

2. Shërbimet e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve që nuk janë subjekt për autorizim

2.1 Transportuesit jorezidentë kryejnë shërbime të rastit, të liberalizuara në përputhje me ligjin nr.9305, datë 4.11.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen “Për transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus” (Marrëveshja Interbus) dhe marrëveshjet bilaterale të përfunduara me shtete të veçanta.

2.2 Në ndryshim nga pika 1.1 shkronja “b” e këtij kapitulli, nëse në marrëveshjen bilateral parashikohet që një transportues jorezident ka të drejtë të kryejë shërbime të rregullta të specializuara, të liberalizuara, ai do të lejohet vetëm nëse ndërmjet tij dhe organizatorit ka një kontratë të përfunduar.

2.3 Udhëtimet bosh të autobusëve të një transportuesi jorezident për shërbimet e transportit të udhëtarëve të liberalizuara, të cilat kryen sipas pikave 2.1 dhe 2.2 të këtij kapitulli nuk janë subjekt për autorizim.

3. Transporti ndërkombëtar rrugor për llogari të vet

3.1 Operacionet e transportit për llogari të vet mundet ose jo të jenë subjekt për autorizim respektivisht në përputhje me marrëveshjet bilaterale ose multilaterale. Në rastin kur ato nuk janë subjekt për autorizim janë subjekt i dokumenteve të parashikuara në marrëveshjet bilaterale ose multilaterale.

3.2 Transportuesit jorezidentë për llogari të vet janë të ndaluar të kryejnë shërbimet e përmendura në pikën 1.1 të këtij kapitulli.

KAPITULLI II
SHËRBIMET, SUBJEKT PËR AUTORIZIM DHE SHËRBIMET E PËRJASHTUARA NGA AUTORIZIMI

1. Shërbimet, subjekt për autorizim dhe natyra e autorizimit

1.1 Autorizimi për shërbimet sipas pikës 1.1 të kapitullit I të këtij kreu lëshohet në emër të transportuesit të huaj (jorezidentë) dhe nuk është i transferueshëm.

1.2 Periudha maksimale e vlefshmërisë së autorizimit për shërbimet e rregullta të lëshuara, parashikohet në marrëveshjet bilaterale, por ajo, në asnjë rast, nuk është më e gjatë se 5 vjet.

1.3 Autorizimi për shërbimet vajtje-ardhje do të përfundojë në datën e dëshmuar nga mbajtësi I autorizimit në njoftimin dërguar autoritetit të lëshimit të autorizimit e të shënuar në autorizim.

1.4 Autorizimi sipas pikës 1.3 të këtij kapitulli për shërbimet vajtje-ardhje lëshohet në përputhje me marrëveshjet bilaterale dhe paraqitet në dy forma:

a) për një periudhë të caktuar kohe; ose

b) për një numër të caktuar udhëtimesh.

1.4.1 Periudha maksimale e vlefshmërisë së autorizimit të lëshuar për shërbimet vajtje-ardhje sipas pikës 1.4 shkronja “a” parashikohet në marrëveshjet bilaterale, por ajo, në asnjë rast, nuk është më e vogël se 6 muaj dhe nuk është më e gjatë se 2 vjet, ndërsa për një autorizim sipas pikës 1.4 shkronja “b” të këtij kapitulli numri i udhëtimit nuk është më i madh se 30.

1.5 Me përjashtim të shërbimeve të rastit të paliberalizuara, autorizimet e shërbimeve të tjera do të specifikojnë kryesisht:

a) llojin e shërbimit;

b) itinerarin e shërbimit, duke specifikuar në mënyrë të veçantë vendin e nisjes dhe vendin e destinacionit, pikat e kalimit të kufirit, pikat e ndalimit ku udhëtarët kanë hipur ose kanë zbritur dhe, në rastin e shërbimeve të rregullta të specializuara, kategorinë e personave të pranuar për transport dhe destinacionin e tyre;

c) periudhën e vlefshmërisë së autorizimit;

ç) frekuencën e shërbimeve;

d) ndalimet dhe tabelën e orareve;

dh) emrin e operatorit/operatorëve të transportit dhe, kur del nevoja për nënkontraktorin;

e) kushte speciale nëse ka;

ë) periudhën e operimit të shërbimit të rregullt të specializuar.

1.6 Transportuesi jorezident, i cili zotëron një autorizim për shërbimet e rregullta, të ose vajtjetardhje të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, të lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ose organet e caktuara prej saj në territorin e Shqipërisë, është i detyruar që të operojë në atë pjesë të territorit sipas itinerarit të kalimit të shërbimit të miratuar më parë nga organi i lëshimit.

Ndryshimi i itinerarit në një autorizim miratohet nga organi që e ka lëshuar atë. Autorizimi është i detyrueshëm të mbahet në mjet për gjatë gjithë udhëtimit.

1.7 Transportuesi jorezident i shërbimeve të rregullta ose vajtjet-ardhje mund të shtojë mjete vetëm në situata të përkohshme dhe të jashtëzakonshme, por mjete të tilla përdoren me kushte të njëjta si ato të përmendura në pikën 1.5 të kapitullit I të këtij kreu.

1.7.1 Në këtë rast, transportuesi do të garantojë që dokumentet si vijon do të mbarten në mjet:

a) një kopje e autorizimit të shërbimit të rregullt ose vajtje-ardhje;

b) një kopje e kontratës ndërmjet operatorit të shërbimit të rregullt dhe ndërmarrjes që ofron mjetet shtesë ose një dokument ekuivalent;

c) një kopje e certifikuar e licencës në ushtrimin e veprimtarisë së operatorit të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, i cili ka ofruar mjetet shtesë.

1.8 Kontrolli i udhëtimit në hyrje dhe udhëtimit në kthim i një grupi udhëtarësh për shërbimet vajtje-ardhje kryhet nga nëpunësit e organeve të kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit, të përmendura në kapitullin II të kreut IV në përputhje me përkufizimin e shërbimeve vajtje-ardhje sipas shkronjës “m” të aneksit 1, bashkëlidhur rregullores.

1.8.1 Në shërbimet vajtje-ardhje, për çdo udhëtim në hyrje, organet e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit fotokopjojnë listën e grupit të udhëtarëve në hyrje, dhe kur transportuesi jorezident kryen udhëtimin pasues në kthim, ato kontrollojnë përputhshmërinë e listës së grupit të udhëtarëve të udhëtimit në hyrje që e ka kryer më parë me listën e grupit të udhëtarëve që rikthehen në zonën e nisjes me udhëtimin pasues.

1.9 Në shërbimet e rastit të paliberalizuara, nëpunësit e organeve të kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit të përmendura në kapitullin II të kreut IV kontrollojnë autorizimin dhe listën e udhëtarëve bashkëlidhur autorizimit. Grupi i udhëtarëve në hyrje duhet të jetë i njëjtë me grupin e udhëtarëve në dalje.

1.10 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit njofton organet e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit dhe organet e kontrollit në rrugë për çdo autorizim të lëshuar për një transportues jorezident për shërbimet e paliberalizuara të kryera sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 1.1 të kapitullit I të këtij kreu. Së bashku me njoftimin bashkëlidhet një kopje e autorizimit.

1.11 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në fund të çdo viti paraardhës për vitin pasardhës, ose rast pas rasti gjatë vitit, informon organet e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit dhe ato të kontrollit në rrugë të përmendura në kapitullin II të kreut IV lidhur me formën e sasinë e lejeve të transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve për shërbimet e rastit të paliberalizuara dhe shërbimet vajtje-ardhje sipas pikës 1.4 shkronja “b” të këtij kapitulli që shkëmbehen me çdo shtet.

2. Shërbimet e përjashtuara nga autorizimi

2.1 Transportuesit jorezidentë kryejnë shërbime të rastit të liberalizuara në përputhje me Marrëveshjen Interbus, ose në përputhje me marrëveshjet bilaterale me shtetet të cilat nuk janë anëtare të kësaj marrëveshje, por ka një marrëveshje bilaterale të përfunduar. Këto shërbime shoqërohen me librin e udhëtimit, i cili përmban dokumentin e udhëtimit (listën e udhëtarëve) të plotësuar.

2.2 Dokumenti i udhëtimit, i cili konsiderohet si dokument kontrolli, plotësohet para nisjes së udhëtimit dhe përmban të paktën informacionin si vijon:

a) llojin e shërbimit;

b) itinerarin kryesor;

c) emrin e transportuesit/transportuesve të përfshirë.

2.3 Librat me fletët e udhëtimit lëshohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ose organet e caktuara prej saj. Modeli i librit të udhëtimit dhe fletëve të udhëtimit janë në përputhje me modelet e caktuara në Marrëveshjen Interbus, ndërsa me shtetet të cilat nuk janë anëtare të Marrëveshjes Interbus, modeli i listës së udhëtarëve caktohet në përputhje me marrëveshjen bilaterale dhe miratohet nga ministri përgjegjës për transportin.

2.4 Në shërbimet e rastit, grupi i udhëtarëve në hyrje është i njëjtë me grupin e udhëtarëve në dalje. Nëpunësit e organeve të kontrollit të përmendura në kapitullin II të kreut IV në pikat e kalimit të kufirit vulosin, nënshkruajnë dhe fotokopjojnë listën e grupit të udhëtarëve në hyrje të pikës doganore të kalimit të kufirit, dhe kur transportuesi jorezident kryen udhëtimin në dalje, kontrollojnë përputhjen e listës në hyrje me atë në dalje.

2.4.1 Nëse në itinerarin e udhëtimit në shërbimet e rastit pika e hyrjes dhe pika e daljes të kalimit të kufirit janë të ndryshme, organet e kontrollit në pikën e kalimit të kufirit në hyrje i përcjellin urgjentisht pikës së kalimit të kufirit në dalje kopjen e listës së udhëtarëve.

2.5 Transportuesit jorezidentë, që kryejnë shërbime të rregullta, të specializuara, të liberalizuara të përmendura në pikën 2.2 të kapitullit I të këtij kreu, si dokument kontrolli mbajnë në bordin e mjetit kontratën ose një kopje të certifikuar.

2.6 Nëpunësit e organeve të kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit i refuzojnë hyrjen në territorin e Shqipërisë një transportuesi jorezident nëse ai nuk është i pajisur me dokumentet e përmendura në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, në këtë rregullore ose në akte të tjera.

2.7 Cilido transportues jorezident që nuk zbaton rregullat e operimit të transportit për shërbimet sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1.1 të kapitullit I të këtij kreu kryen shkelje serioze në transportin rrugor.

2.8 Autoriteti që ka lëshuar autorizimin për shërbimet e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve sipas pikës 1.1 të kapitullit I të kreut III e tërheq atë kur zotëruesi i autorizimit nuk plotëson në vazhdimësi plotësimin e kushteve në bazë të të cilit është lëshuar autorizimi, sidomos kur tërheqja kërkohet nga organi i shtetit të vendosjes së transportuesit. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit njofton menjëherë organet e shtetit të interesuar mbi masat që ka marrë.

2.9 Transportuesit që operojnë në një shërbim të rregullt sipas pikës 1.1 shkronja “a” të kapitullit I të këtij kreu, lëshojnë bileta individuale ose kolektive që tregojnë:

a) pikën e nisjes dhe mbërritjes, kur është e përshtatshme udhëtimin në kthim;

b) periudhën e vlefshmërisë së biletës;

c) tarifën e transportit.

2.9.1 Biletat shërbejnë si dokument kontrolli dhe i paraqiten çdo nëpunësi të kontrollit sipas kapitullit II të kreut IV kur kërkohet prej tyre.

KREU IV

KAPITULLI I

ASISTENCA RECIPROKE DHE SANKSIONET

1. Asistenca reciproke

1.1 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në fund të çdo tremujori, do t'i komunikojë të dhënat në lidhje me operacionet e kabotazhit të kryera nga transportuesit jorezidentë në Shqipëri, institucionit homolog të shtetit ku ata janë të vendosur.

1.2 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në bazë të reciprocitetit, i kërkon të dhënat mbi kryerjen e operacioneve të kabotazhit në Shqipëri institucioneve homologe të shtetit ose vendit për transportuesit e saj.

1.3 Të dhënat janë shprehur në tonë të transportuara dhe tonë/kilometra. Modeli i tabelës jepet me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin.

1.4 Në zbatim të kësaj rregulloreje, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit do të bashkëpunojë nga afër me ministritë homologe të shteteve të tjera, dhe për licencat ECMT e për lejet multilaterale BSEC, respektivisht, me sekretariatet të këtyre organizatave.

1.5 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do të shkëmbejë informacion me organet përgjegjëse të transportit rrugor në zbatimin e kësaj rregulloreje. Informacioni do të shkëmbehet në rrugë elektronike sipas pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.325, datë 19.3.2008 “Mbi rregullat për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor të operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe njohja e dokumenteve zyrtare të caktuar për këta operatorë”.

2. Sanksionet për shkeljet e transportuesve të huaj në Shqipëri (në shtetin pritës)

2.1 Kryerja e operacioneve të transportit nga transportuesit e huaj (jorezidentë) të pajisur me leje sipas të pikës 2.1 të kapitullit I të kreut II, përveç dispozitave të marrëveshjeve bilaterale ose multilaterale do të jetë subjekt i të gjithë kuadrit ligjor shqiptar, përfshirë dhe atë të transportit rrugor.

2.2 Organet e kontrollit sipas kapitullit II të këtij kreu, do të njoftojnë Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për shkeljet e regjistruara dhe për masën e dënimit të vendosur ndaj transportuesit në rastin e shkeljeve serioze ose shkeljeve të përsëritura. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit brenda 6 javëve njofton organet homologe të shtetit të vendosjes së transportuesit jorezidentë për vendimin e marrë nga organet e kontrollit, duke e shoqëruar me informacionin e nevojshëm si vijon:

a) një përshkrim i shkeljes dhe datën dhe kohën kur shkelja ka ndodhur;

b) kategoria, lloji dhe serioziteti i shkeljes; dhe

c) dënimet e vendosura dhe dënimet e ekzekutuara.

2.3 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit mund t'i kërkojë shtetit të vendosjes së transportuesit jorezidentë që të vendosë dënime sipas pikës 2 të këtij kapitulli.

2.4 Çdo transportues jorezident, i cili ndëshkohet për shkelje të dispozitave të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” dhe dispozitave të kësaj rregulloreje e akteve të tjera nënligjore, ka të drejtën e ankimit.

2.5 Në bazë të nenit 26 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, cilido transportues jorezident, ndaj të cilit është vendosur një dënim administrativ, ka të drejtën e ankimit në rrugë gjyqësore.

KAPITULLI II

ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE REGJISTRIMI ELEKTRONIK

1. Organet e zbatimit të ligjit

1.1 Organet e zbatimit të legjisllacionit për fushën e transportit rrugor në pikat e kalimit të kufirit, janë nëpunësit e organeve të kontrollit të Policisë Kufitare, organeve doganore dhe organeve të kontrollit shtetëror, të specializuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

1.2 Për kontrollin në anë të rrugës, ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpunësit e kontrollit sipas nenit 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe nëpunësit e Policisë Tatimore.

1.3 Kontrolli i mjeteve bëhet në pikat e kalimit të kufirit e në vende të posaçme për këtë qëllim, i planifikuar ose i rastësishëm dhe i organizuar me përbërje të një ose disa organeve të kontrollit.

1.4 Organet e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit informojnë çdo tre muaj ose sipas rastit me kërkesë të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit mbi sasinë dhe llojet e lejeve sipas pikës 2.1, shkronja “a” të kapitullit I të kreut II të përdorura nga transportuesit jorezidentë për çdo shtet më vete.

1.5 Organet e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit duhet të regjistrojnë llojin e lejes, që përdor transportuesi jorezident, së bashku me specimenet e saj.

1.6 Organet e kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit informojnë për çdo rast Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit nëse konstatojnë se një transportues jorezident nuk kryen një shërbim në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, të ofruar, sipas rregullave të marrëveshjeve bilaterale ose multilaterale dhe legjislacionit për transportin rrugor.

1.7 Pa përjashtuar pikën 1.4 dhe 1.5 të këtij kapitulli, organet e kontrollit sipas këtij kapitulli japin çdo informacion Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për çështje të tjera që kanë lidhje me transportin.

1.8 Rregullat e hollësishme të bashkëpunimit ndërmjet organeve të zbatimit të legjislacionit për fushën e transportit rrugor, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm.

1.9 Nëpunësit e organeve të kontrollit në pikat doganore të kalimit të kufirit dhe në rrugë, duhet kryejnë trajnime të vazhdueshme për kualifikimin e tyre lidhur me mënyrën e operimit dhe me dokumentet e nevojshme në funksion të llojit të lejes ose licencës në transportin e mallrave, ose të llojit të autorizimit në shërbimet e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve të paliberalizuara, ose të llojit të shërbimeve të transportit ndërkombëtar rrugor të liberalizuara të udhëtarëve me të cilën është i pajisur një transportues jorezident.

2. Regjistrimi i shkeljeve në regjistrin elektronik

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.325, datë 19.3.2008 do të regjistrojë në regjistrin elektronik të gjitha shkeljet serioze të kryera nga transportuesit shqiptarë në një shtet tjetër, që kanë çuar drejt pezullimit ose heqjes së licencës për këta transportues.

KAPITULLI III DISPOZITA KALIMTARE

Autorizimet e shërbimeve sipas pikës 1.1 të kapitullit I të kreut III, të lëshuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të mbeten në fuqi deri më datën e përfundimit të vlefshmërisë së tyre.

Për qëllime të kësaj rregulloreje do të përdoren përkufizimet si vijon:

- a) “Mjet” nënkupton një mjet motorik i regjistruar në një shtet tjetër² ose në rastin e një kombinimi çift të mjeteve, të paktën, mjete motorik është i regjistruar në shtetin e vendosjes së transportuesit, i përdorur ekskluzivisht vetëm për transportin e mallrave. Mjeti mund të jetë pronë e transportuesit ose mund të jetë në dispozicion të tij përmes një kontrate qiramarrje.
 - b) “Shtet anëtar pritës” nënkupton një shtet, në të cilin një transportues mallrash operon përveç shtetit të vendosjes së transportuesit.
 - c) “Transportues jorezident” nënkupton një ndërmarrje transporti e vendosur në një shtet tjetër, e cila operon brenda territorit të shtetit pritës.
 - ç) “Shtet anëtar i BSEC-së” nënkupton një vend, i cili është anëtar i Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Vendeve të Detit të Zi (BSEC).
 - d) “Karakterit multilateral i lejes BSEC” nënkupton mundësinë e përdorimit të lejes së BSEC për udhëtimet transit, përmes territoreve të shteteve anëtare pjesëmarrëse, përveç vendit të vendosjes së ndërmarrjes së transportit.
 - dh) “Karakterit multilateral i lejes ECMT” nënkupton mundësinë e përdorimit të licencës së ECMT-së për udhëtimet ndërmjet vendeve anëtare të kuotës së ECMT-së, përveç vendit të vendosjes së ndërmarrjes së transportit.
 - e) “Leja e BESEC-së” nënkupton lejen, e cila është e vlefshme për një udhëtim të vetëm vajtjeardhje, transit përmes territoreve të shteteve anëtare pjesëmarrëse dhe ka një periudhë vlefshmërie të specifikuar.
 - ë) “Licencë ECMT” nënkupton një leje, e cila është e vlefshme për një numër udhëtimesh të përcaktuar në pikën 3.6 brenda një periudhe të specifikuar kohore ndërmjet vendeve anëtare dhe e shoqëruar nga libri i udhëtimeve i plotësuar siç duhet.
 - f) “Transit” nënkupton një udhëtim përmes territorit të një vendi në të cilin as nuk ngarkohen e as nuk shkarkohen mallra.
 - g) “Trafiku për vende të treta” nënkupton transportin e mallrave të ngarkuara në një vend dhe shkarkimin në një vend të dytë me një mjet të regjistruar në një vend, përveç atij, në të cilin transporti nis ose përfundon.
 - gj) “Kuota” nënkupton numrin maksimal të lejeve (autorizimeve), të lëshuara për mjetet e pranuar nga një vend te vendi tjetër brenda një periudhe të specifikuar.
 - h) “Transporti ndërkombëtar i mallrave me rrugë” nënkupton udhëtimet me anën e një mjeti, i ngarkuar ose i pangarkuar, që kalon kufijtë e të paktën një vendi tjetër me ose pa transit përmes një ose më shumë vendeve.
 - j) “Kabotazhi” nënkupton një operacion transporti ku mallrat janë ngarkuar dhe shkarkuar në dy pika të veçanta (të ndryshme) brenda një vendi, me anën e një mjeti, i cili është i regjistruar në një vend tjetër, ku të paktën mjeti motorik është i regjistruar në vendin e vendosjes së transportuesit jorezidentë.
 - k) “Shkelje serioze të legjisllacionit të transportit rrugor” nënkupton një shkelje, e cila mund të çojë në humbjen e reputacionit të mirë dhe si rezultat tërheqjen e përkohshme ose të përhershme të licencës së një transportuesi nga organet e licencimit të shtetit ose vendit të vendosjes. Shkelje serioze në Shqipëri konsiderohen shkeljet e kushteve të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.325, date 19.3.2008 “Mbi rregullat e pranimit në veprimtarinë e transportit rrugor të operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe njohja e dokumenteve zyrtare të caktuara për këta operatorë”.
 - l) “Shërbimet e rregullta” nënkupton shërbimet, të cilat ofrojnë për transportin e udhëtarëve në intervale të caktuara përgjatë itinerareve (kalimeve) të specifikuara, ku udhëtarët hipin dhe zbresin në pikat e ndalimit të paracaktuara.
 - ll) “Shërbimet e rregullta të specializuara” nënkupton shërbimet e rregullta, të organizuara nga cilido, që ofron për transportin e kategorive specifike të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët e tjerë.
- ² Me shtet tjetër në këtë rregullore do të kuptojmë një shtet anëtar të BE-së, shtet joanëtar të BE-së, vend anëtar të CEMT ose shtet anëtar të BSEC-së, në varësi të lejes ose autorizimit që përdor transportuesi.

m) “Shërbimet vajtje-ardhje të udhëtarëve” nënkupton shërbimet që organizohen për të transportuar grupe udhëtarësh të formuar më parë nga e njëjta zonë nisjeje dhe me të njëjtën zonë destinacioni me udhëtime të përsëritura vajtje dhe kthim. Të tilla grupe, të përbëra nga udhëtarë që kanë kryer udhëtimin e vajtjes, rikthehen në zonën e nisjes me anën e një udhëtimi pasues.

Zonë nisjeje dhe destinacioni quhen vendet, së bashku me lokalitetet rrethuese, në të cilat respektivisht fillon dhe mbaron udhëtimi.

Në shërbimin vajtje-ardhje, nuk merren ose lihen udhëtarë gjatë udhëtimit.

Udhëtimi i parë në kthim dhe udhëtimi i fundit në vajtje, për një seri udhëtimesh vajtje-ardhje, duhet të kryhen me autobus bosh.

n) “shërbimet e rastit” nënkupton shërbimet, të cilat nuk përputhen me përkufizimin e shërbimeve të rregullta, që përfshin shërbimet e rregullta të specializuara dhe shërbimet vajtje-ardhje, dhe karakteristikë kryesore e të cilës është transporti i grupeve të udhëtarëve të formuar me iniciativën e klientit ose vetë transportuesit.

o) “Operacionet e transportit për llogari të vet të udhëtarëve” nënkupton transportet e kryera për qëllime jotregtare dhe jofitimprurëse nga një person fizik ose juridik, me kusht që:

- veprimtaria e transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për personin fizik ose juridik;

- mjetet e përdorura të jenë pronë e personit fizik ose juridik ose janë blerë me këste nga ky person, ose janë objekt i një kontrate qiramarrjeje me afat të gjatë dhe drejtohen nga një anëtar i stafit të personit fizik ose juridik ose nga vetë personi fizik ose nga personeli i punësuar prej, ose i vendosur në dispozicion të, ndërmarrjes sipas një detyrimi kontraktual.

p) “Autobus” nënkupton mjetin motorik, me ose pa rimorkio për transportin e udhëtarëve dhe bagazheve të tyre, i destinuar në saje të konstruksionit dhe pajisjes së tyre për transportin e më shumë se nëntë personave që përfshin edhe drejtuesin e mjetit, dhe i caktuar për këtë përdorim.

q) “Autorizim” nënkupton një dokument që autorizon përdorimin e një autobusi në territorin e një shteti tjetër përveç atij të regjistrimit dhe vendosjes së operatorit të transportit në lidhje me shërbimet e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve me rrugë sipas pikës 1.1 të kapitullit I të kreut III të rregullores;

r) “Shërbimi i udhëtarëve me rrugë” nënkupton transportin me autobus të ofruar për publikun ose për disa kategori të përdoruesve i paguar nga personi i transportuar ose nga organizatori i transportit;

rr) “Autoriteti i autorizimit” nënkupton autoritetin kompetent të shtetit në territorin e të cilit ndodhet pika e nisjes, tek e cila aplikimi për një autorizim është paraqitur, dhe e cila lëshon autorizimin.

Shteti i nisjes nënkupton “një prej stacioneve fundore të shërbimit”.

s) “Drejtues mjeti” nënkupton çdo person, i cili drejton mjetin ose për një periudhë të shkurtër, ose, i cili ndodhet në mjet si pjesë e detyrimeve të tij për të qenë i gatshëm për drejtim nëse është e nevojshme.